29 shtator 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 29.09.2026, Prishtinë

Organizatori i Superkupës së Kosovës për Femra 2026

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që rrjedhin nga Statuti i FBK-së, përkatësisht neni 24, dhe pas shqyrtimit të aplikimit të KBF Peja 03 për organizimin e Superkupës së Kosovës për Femra 2026, Bordi i FBK-së vendos si në vijim:

1. Miratohet kërkesa e KBF Peja 03 për organizimin e Superkupës së Kosovës për Femra 2026, e cila do të zhvillohet me datë 6 tetor 2026, ndërmjet KBF Bashkimi dhe KBF Peja 03, në Palestrën Sportive "Karagaçi" në Pejë.
2. KBF Peja 03 obligohet që të përmbushë të gjitha kërkesat organizative, teknike dhe të sigurisë, si dhe obligimet financiare të përcaktuara nga FBK-ja në Konkursin/Thirrjen për organizimin e Superkupës së Kosovës për Femra 2026, e që do specifikohen edhe me kontratën ndërmjet FBK-së dhe KBF Peja 03.
3. Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së që, në emër të FBK-së, të lidhë kontratën me KBF Peja 03 për organizimin e Superkupës së Kosovës për Femra 2026.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,
Arben FETAHU

Federata e Basketbollit të Kosovës

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVA
FBK
PRISTINA
PRIŠTINA
PRISHTINË

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com
rr. Radovan Zogovic, Blloku C3, nr38, Arbëria
Prishtina 10000, Republika e Kosovës